

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**TIRANË**

**Nr. Regj.Themletar 793/3312**

**Nr.Vendimi 2721**

**Data e regj.17.01.2022**

**Datë 17.11.2022**

**V E N D I M**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

**GJYQTARE: REXHINA MERLIKA**

Asistuar prej sekretare gjyqësore Shefqet Shehu, sot më date **17.11.2022**, mori në shqyrtim çështjen penale me Nr.3312 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurore Ornela Rrumbullaku.

**I PANDEHUR:** Afrim Shaqiri, i biri i Ramazan dhe Vjollca, i datëlindjes 10.08.1985, lindur dhe banues në Tiranë, Kombinat, Rr.Fadil Adushi, banese private, me gjendje civile i martuar, pa arsim, me shtetësi shqiptare, hetuar pa mase sigurimi, me gjendje gjyqësore i denuar, identifikuar karte identiteti me nr.I50810219R, mbrojtur në gjykim nga Av.Luljeta Drogu, caktuar kryesisht nga gjykata.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, dëgjoi palët, të cilat në diskutimin përfundimtar kërkuan:

Prokurori: Deklarimin fajtor të të pandehurit Afrim Shaqiri, për kryerjen e veprës penale "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283, paragrafi i I-rë i K.Penal, dënimin e tij në bazë të nenit 283/1 të K.Penal me 5 (pesë) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të pandehurit t'i ulet 1/3 e masës së mësipërme të dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Afrim Shaqiri me 3 (tre) vjet dhe 4 (katër) muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit të mësipërm me burgim dhe vendosjen e të pandehurit në provë. Në bazë të nenit 190/1(b) të Kodit të Procedurës Penale lenda narkotike esekuestruar (pjesa e mbetur pas ekspertimit) të asgjësohet. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake dhe shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të pandehurit.

Av.Luljeta Drogu: Jemidakort me llojin e dënimit të kërkuar nga prokurori dhe kërkohet të aplikohet neni 59 i K.Penal.

I pandehuritha: Jam dakort me avokatin. Ndihemthelësisht i penduar për veprimet e kryeranga ana imedhepremtoj se nuk do teperserise me veprimete tilla në teardhmendhekerkojmëshirëngajykata.

**VËREN**

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesën me objekt dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Afrim Shaqiri, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe pushimin e hetimeve për personin nën hetim Emra Demiri, pasi ai ka vdekur.

Në seancën paraprake datë 17.11.2022 nga i pandehuri nuk u parashtrua asnjë pretendim pavlefshmërie, papërdorshmërie të provave, apo kërkim për marrjen e provave të reja, por u kërkuar aplikimi i gjykimit të shkurtuar duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorisë të sjellë për gjykim.

Në këto kushte gjykata bazuar në nenet 403, 332/dh gërma "c" (i ndryshuar me Ligjin Nr. 41/2021) dhe nenin 405/6 të K.Pr. Penale, pasi u njoh me aktet hetimore, vendosi të procedojë me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjendjen që janë paraqitur aktet nga organi i akuzës, pasi jo vetëm nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk u paraqitën pretendime pavlefshmërie, papërdorshmërie apo marrje të provave të reja, por as nga gjykata nuk u konstatuan pavlefshmëri apo papërdorshmëri të provave.

Ky disponim i gjykatës është në përputhje me dispozitat proceduriale të cilat parashikojnë gjykimet e posaçme si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, sipas të cilit ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim i posaçëm bën që gjykimi të zhvillohet në tërësi sipas fashikullit të prokurorit, i cili kthehet në dosje gjyqësore dhe që përbën bazën e shqyrtimit të çështjes, çmuarjes dhe analizës së provave në gjendjen që kanë ardhur për gjykim.

Lidhur me kërkesën për pushimin e hetimeve për personin nën hetim Emra Demiri, pasi ai ka vdekur, gjykata në seancë paraprake ka vendosuar: "*Pranimin e kërkesës.-Pushimin e çështjes penale Nr.793 Regj.Themeltar, datë regjistrimi 17.01.2022, që i përket procedimit penal Nr.8175 datë regjistrimi 19.11.2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim Emra Demiri.-Shpenzimet proceduriale dhe ato gjyqësore siç janë bërë.-Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve duke filluar ky afat për viktimën, nga dita e nesërme e shpalljes së tij.-U shpall në Tiranë , me datë 17.11.2022.*"

Nga verifikimi në tërësi i akteve, gjatë shqyrtimit me gjykim të shkurtuar rezultoi se: Në datën 18.11.2020 rreth orës 10.00 punonjësit e seksionit kundër luftës ndaj narkotikëve kanë marrë njoftim se në rrugën "Lazi Miho" kishte aktivitet të shitblerjes së lëndëve narkotike. Mbi këtë bazë është ngritur grup vëzhgimi dhe gjatë mbikqyrjes pranë karburant "Braka" janë evidentuar dy shtetas të cilët janë identifikuar si Emra Demiri dhe Afrim Shaqiri. Ndaj tyre është ushtruar kontroll dhe shtetasit Emra Demiri i janë gjetur dy qese të vogla plastike me lëndë të dyshuar "Heroinë". Gjithashtu këtij shtetasi ju gjet një kuti cilindrike me mbishkrimin "metadon" brenda të cilës kishte 22 kokrra metadon. Ndërsa shtetasit Afrim Shaqiri ju gjet një qese plastike me lëndë të dyshuar "heroinë", një shiringë dhe dy shishe qelqi me mbishkrimin diazepam. Këta shtetas janë shoqëruar në Drejtorinë e Policisë, ku janë peshuar lëndët e dyshuarasi narkotike. Sasia që i është gjetur shtetasit Emra Demiri ishte në masën 0.8gramë kurse tabletat metadon ishin në masën 3.4 gramë. Sasia që i është gjetur shtetasit Afrim Shaqiri ishte 0.4 gramë heroinë. Janë pyetur këta shtetas dhe shtetasi Emra Demiri ka pranuar se ka rreth një muaj që merret me shitblerjen e lëndëve narkotike për arsye ekonomike. Mundohet ti blejë me rreth 10.000 lekë të vjetra grami dhe ti shesë 50.000 lekë të vjetra gramin.

Shtetasi Afrim Shaqiri ka shpjeguar se është përdorues i lëndës narkotike prej shumë kohësh dhe kohët e fundit ka blerë doza të Emra Demiri në çmimin 8.000 lekë deri 10.000 lekë të vjetra. Sasinë që ju gjet e ka për përdorim vetjak.

Nga ekspertimi kimik sipas aktit nr.1748 datë 18.02.2021 është përcaktuar sesasia e pluhurit që ju kap shtetasi Afrim Shaqiri është heroinë në masën 0,244 gr. Nga akti ekspertimi mjeko-ligjor nr.2521 datë 14.12.2020 është përcaktuar se shtetasi Afrim Shaqiri është përdorues i heroinës. Këto akte i janë vënë në dispozicion mjekut ligjor i cili në aktin e ekspertimit nr. 2640 datë 21.10.2021 ka përcaktuar se sasia prej 0,244 gr që ju kap shtetasi Afrim Shaqiri është sasi e rrezikshme për shëndetin dhe nuk është sasi për përdorim personal.

Në këto rrethana prokurori ka konkluduar se i pandehuri Afrim Shaqiri me veprimet e tij të kryera me dashje ka konsumuar elementët e veprës penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Nga ana e prokurorit të çështjes është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit, Afrim Shaqiri, për kryerjen e veprës penale "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283, paragrafi i I-rë i K.Penal, dënimit të tij në bazë të nenit 283/1 të K.Penal me 5 (pesë) vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të pandehurit t'i ulet 1/3 e masës së mësipërme të dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin, Afrim Shaqiri me 3 (tre) vjet dhe 4 (katër) muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të K.Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vendosjen e të pandehurit në provë.

Ndërsa mbrojtësi i të pandehurit u shpreh se është dakort me llojin e dënimit të kërkuar nga prokurori.

I pandehuri deklaroi se është dakort me avokatin, ndihet thellësisht i penduar për veprimet e kryera dhe se premtonte se nuk do të perserise me veprime të tilla në të ardhmen duke kërkuar mëshirë nga gjykata.

### **Vlerësimi i gjykatës**

Në rastin konkret gjykata i referohet nenit 283/1 të K.Penal i cili parashikon "Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin, ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet."

Nga interpretimi i dispozitës së cituar më lart, arrihet në përfundimin se ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, veçanërisht jetën dhe shëndetin e personit, rregjimin juridik për shitjen, dhënie, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal edhe Ligjit Nr.7975, datë 26.07.1995 "Për barnat narkotike dhe psikotrope" nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive, i pandehuri, Afrim Shaqiri, me veprime aktive, të kundraligjshme, ka konsumuar elementët e kësaj vepre penale në formën e mbajtjes. Me datën 18.11.2020 pranë karburant "Braka" ai së bashku me shtetasin Emra Demiri janë kapur nga punonjësit e policisë dhe nga kontrolli i ushtruar të pandehurit Afrim i janë gjetur e sekuestruar një qese plastike me lëndë të dyshuar "heroinë", një shiringë dhe dy shishe qelqi me mbishkrimin diazepam. Lënda narkotike pasi është peshuar ka rezultuar 0.4 gramë heroinë për të cilën ai ka deklaruar se e kishte për përdorim vetjak, pasi është përdorues i saj prej shumë kohësh dhe kohët e fundit ka blerë doza të Emra Demiri në çmimin 8.000 lekë deri 10.000 lekë të vjetra.

Nga akti i ekspertimi kimik Nr.1748 datë 18.02.2021 është përcaktuar sasia e pluhurit që i është sekuestruar shtetasit Afrim Shaqiri është heroinë në masën 0,244 gr. Nga akti i ekspertimi mjeko-ligjor nr.2521 datë 14.12.2020 është përcaktuar se shtetasi Afrim Shaqiri është përdorues i heroinës. Ndërsa sipas aktit të ekspertimit nr. 2640 datë 21.10.2021 është përcaktuar se sasia prej 0,244 gr e kapur shtetasit Afrim Shaqiri është sasi e rrezikshme për shëndetin dhe nuk është sasi për përdorim personal.

Në rastin konkret duke analizuar këtë element të veprës penale gjykata referohet jo vetëm në dispozitën konkrete penale, por edhe unifikimin e praktikës gjyqësore të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Kështu sipas Vendimit unifikues Nr.1, datë 27.03.2008 të Gjykatës së Lartë, gjykata vlerëson se, përgjegjësia penale në kryerjen e kësaj vepre penale kushtëzohet domosdoshmërisht nga ekzistenca bashkarisht e dy kërkesave ligjore: së pari i pandehuri të jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe se dyti mbajtja prej tij të mos jetë e një dozetë vogël për një përdorim të vetëm. Në rastin konkret, duke qenë se sasia e lëndës narkotike prej rreth 0,244 gram, "heroinë" sekuestruar të pandehurit referuar praktikës gjyqësore tashme të unifikuar krijon bindjen se nuk është për përdorim vetjak. Po kështu, në rastin specifik të trajtuar nga Gjykata e Lartë në disponimin e saj për unifikimin e praktikës gjyqësore, kjo e fundit ka evidentuar se sasia e lëndës narkotike sekuestruar të pandehurit në atë rast nuk ishte për një përdorim të vetëm, por për disa të tilla dhe gjatë gjithë ditës (siç është rasti konkret objekt shqyrtimi), duke konkluduar se ndodhemi para kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal e kryer në formën e mbajtjes së lëndës narkotike.

Në vendimin nr.63 datë 29.02.2012 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka përcaktuar se: *"Përcaktimi i sasisë së përdorimit vetjak në mungesë të një përcaktimi nga një akt ligjor nga ana e ekspertit toksikologjik duhet të kryhet mbi bazën e një vlerësimi të dalë në bazë të një studimi të përgjithshëm të fenomenit të varësisë nga droga të një subjekti përdorues, ku të përcaktohen kufijtë maksimalë të dozës për përdorim ekskluzivisht personal për çdo substancë narkotike apo psikotrope. Në çdo rast eksperti duhet të përcaktojë për çdo lloj të lëndës narkotike: a) dozën mesatare të vetme e kuptuar si sasia e substancës aktive për çdo marrje të vetme, e aftë për të prodhuar tek një subjekt përdorues dhe dipendent një efekt psikotrop; b) frekuencën mesatare të përditshme të marrjes; c) sasinë e substancës aktive të marrjes në mënyrë të përditshme; d) fuqinë për të shkaktuar ndryshime të sjelljes dhe rënie të aftësive psikomotorë."*

Gjithashtu si element referues për gjykatën për të bërë këtë dallim duhet të jenë dhe rrethanat konkrete, siç mund të jenë: vendi i kapjes, vendi se ku mbahet lënda narkotike, mënyra e paketimit apo sasia e të ardhurave që ka individi të cilat mund të justifikojnë qëllimin e blerjes. Të gjithë këta elementë bëjnë dallimin midis mbajtjes për qëllim shitje, i cili është edhe subjekti i veprës penale dhe përdoruesit si viktimë e fenomenit të drogës". Nga faktet objekt hetimi rezultojnë këto të dhëna: Lënda e sekuestruar të pandehurit Afrim Shaqiri është lëndë narkotike e llojit heroine, në bazë të ligjit nr.7975, datë 26.07.1995 "Për lëndët narkotike dhe barnat psikotrope" konsiderohet si lëndë narkotike; I pandehuri është përdorues i lëndëve narkotike (toksikologjik); Lënda e kapur në një dozë ka peshë të përgjithshme të homogjenizuar dhe pa ambalazh prej 0.244 gram; Ai është kapur në flagrancë nga autoriteti policor, seksioni për hetimin e narkotikeve.

Me veprimet e tij aktive, të kundërligjshmei pandehuri me marrjen dhe mbajtjen e lëndës narkotike jo për përdorim vetjak, provon lidhjen e drejtpërdrejtë shkakësore të veprimeve të tij

me gjetjen dhe sekuestrimin e lëndës narkotike, për shkak të posedimit të saj jo për përdorim vetjak.

Nga kjo analizë gjykata krijon bindjen se veprimet e kryera nga i pandehuri në mbajtjen e lëndës narkotike janë kryer në kundërshtim me parashikimin në dispozitat e Ligjit Nr.7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe psikotrope”, të ndryshuar, ligj i cili e klasifikon “cannabis sativa” si lëndë narkotike.

Subjekti i kryerjes së kësaj vepre penale është pandehuri i cili nga provat e adminstruara në fashikullin e gjykimit rezulton të jetë madhor dhe i përgjegjshëm para ligjit.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri Afrim Shaqiri me faj në formën e dashjes direkte, pasi i pandehuri ka parashikuar kundërligjshmërinë veprimeve të tij dhe pasojat e tyre.

Sa më sipër, rezultoi e provuar fajësia e të pandehurit në kryerjen e këtyre veprave penale nga provat e adminstruara si dhe është pranuar nga i pandehuri autorësia e tyre në hetimin e gjykimin e çështjes.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin, gjykata referohet në nenet 47, 48/ç, 49, 59, 60 të K. Penal, lloji i dënimit për veprat penale të kryera nga i pandehuri përcaktohet nga vetë ligji, neni 283/1 i K. Penal i cili parashikon: “...dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet”, ndërsa nga neni 291 i K.Penal parashikohet dënim me burgeim deri në tre vjet. Këto dispozita, siç shihet, kanë përcaktuar vetëm një lloj dënimit me burgim.

Për sa i përket masës së dënimit, gjykata mban parasysh: Rrezikshmërinë e veprës penale të kryer nga i pandehuri dhe të pasojës së saj. Në këtë kuadër gjykata vëren se vepra penale e "Prodhimit dhe shitjes se narkotikeve", është parashikuar në K.Penal si krim, gjë që tregon çmimin që legjislatori i ka bërë rrezikshmërisë së kësaj vepre. Gjithashtu, gjykata mban parasysh marrëdhëniet juridike që kjo vepër prek ose çënon, që janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar siguri rendin dhe siguri publike, veçanërisht jetën dhe shëndetin e personit, rregjimin juridik për shitjen, dhënie, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal nga veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme, si dhe faktin që kjo vepër dënohet me vetëm me burgim në një minimum pesë vjet deri në 10 vjet. Por gjykata merr parasysh sasinë e lëndës narkotike heroine të sekuestruara cila është shumë e vogël dhe i pandehuri është përdorues i saj, prej vitesh.

Rrezikshmërinë e autorit i cili rezultoi me gjendje gjyqësore i padënuar dhe rrethanat që lidhen me gjendjen sociale e shoqërore të tij. Rrethanat lehtësuese, ku në rastin konkret i pandehuri tregoi në gjykim pendim të thellë, fakt i cili përbën rrethanë lehtësuese parashikuar nga neni 48/ç të K. Penal; Faktin se i pandehuri është përsëritës, ai rezultoi të jetë i dënuar më parë për veprën penale të “Dhunes se familje” dhe në gjykim ai e pranoi fajësinë, gjykata çmon si rrethanë lehtësuese bazuar në nenin 49 të K. Penal. Formën e fajit, i pandehuri e ka kryer veprën me dashje direkte. Ai është hetuar dhe gjykuar pa masë sigurimi personal dhe gjatë kësaj periudhe ka treguar kujdes dhe përgjegjshmëri në lidhje me paraqitjen para organeve kompetente. Po, kështu gjykata merr parasysh faktin që ai nuk është i arsimuar gjë që ka ndikuar në kryerjen e kësaj vepre penale.

Duke vlerësuar rrethanat e çështjes në zbatim të ligjit, kjo gjykatë vlerëson se kërkesa e prokurorit lidhur me llojin dhe masën e dënimit është epërligjshme, ndaj i pandehuri duhet deklaruar fajtor dhe dënuar me 5 (pesë) vjet burgim, për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit duhet t'i i ulet

1/3 (një e treta) e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet 4(katër) muaj burgim. Ky dënim me burgim duhet pezulluar duke u referuar në nenin 59 të Kodit Penal, duke çmuar se koha e provës lidhur me masën e dënimit me burgim si dhe me rrethanat e mësipërme ajo duhet të jetë për të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet.

Aplikimi i këtij dënimi alternativ është në përputhje të plotë me rëndësinë e faktit, rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe realizon plotësisht qëllimin kompleks të dënimit penal për ndëshkimin, riedukimin e të pandehurit dhe parandalimin e përhapjes së veprave penale në shoqërinë tonë.

Gjithashtu gjykata është e detyruar në zbatim të nenit 190/1 gërmat “b” të K.Pr. Penale, prova materiale e sekuestruar sipas proces-verbalit date 18.11.2020, (lenda narkotike e llojit heroine, 0.244 gram dhe 0.434 gram) të asgjësohet.

Sa më sipër gjykata disponon në referim të nenit 393 të K.Pr. Penale lidhur me pagimin e shpenzimeve procedurale të hetimeve paraprakë në vlerën 23.000 (njetzet tremijë) lekë, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenet 283/1 e 47, 48, 49, 59, të K. Penal e 379, 384, 390, 391, 393, 406/1 të K.Pr. Penale.

### **V E N D O S I**

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Afrim Ramazan Shaqiri për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij sipas kësaj dispozite me 5(pesë) vjet burgim.

2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit Afrim Ramazan Shaqiri i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 3(tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim.

3. Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim ndaj të pandehurit Afrim Ramazan Shaqiri, duke e vënë në provë të pandehurin për një periudhë kohe 3 (tre) vjet, me kusht që të mbajë kontakte me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës Tiranë, gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale.

4. Në zbatim të nenit 60, pika 9 të Kodit Penal, i pandehuri Afrim Ramazan Shaqiri urdhërohet që gjatë periudhës së provës të mos shoqërohet me persona të dënuar me parë.

5. Në zbatim të nenit 59/4 të Kodit Penal afati i provës për të pandehurit fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të gjykatës.

6. Në zbatim të nenit 190/1 gërmat “b” të K.Pr. Penale, prova materiale e sekuestruar sipas proces-verbalit date 18.11.2020, (lenda narkotike e llojit heroine, 0.244 gram dhe 0.434 gram) të asgjësohet.

7. Shpenzimet procedurale në fazën e hetimeve paraprake në vlerën 23.000 (njetzet tremijë) lekë si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.

8. Kundër vendimit mund të bëhet ankim nga palët brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë sot me datë 17.11.2022.

**SEKRETARE**

**SHEFQET SHEHU**

**GJYQTARE**

**REXHINA MERLIKA**

**SHPENZIMET GJYQËSORE**

Për njoftime 300 Lekë

Për avokat 3.000 Lekë